

20210771169

**LIGJ I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA
BANKA BOTËRORE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT – BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR
AVANCIMIN E ARSIMIT FILLOR**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit - Banka Botërore në shumë prej 21.500.000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit për avancimin e arsimit fillor.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huas për financimin e Projektit për avancimin e arsimit fillor, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas të paragrafit 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagesës së huas së nenit 1 të këtij ligji është 11 vjet, duke përfshirë grejs periudhën prej tre vjetësh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% nga shuma e huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore provizion në lartësi prej 0.25% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të paguhet në 16 këste gjysmëvjetore, secila në shumë prej 6.25% të shumës së huas. Huaja do të paguhet më 15 mars dhe 15 shtator, çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji është Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan e nenit 1 të këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".